



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2024:198232  
Datë: 19.12.2024  
Numri i dokumentit: 06629284  
PAKR.nr.667/2024

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti i Krimeve të Rënda, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Mentor Bajraktari, kryetar kolegji, Afërdita Bytyçi dhe Valbona Musliu Selimaj, anëtare, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Fitore Batatina, në çështjen penale kundër të akuzuarve A.Xh dhe F.Xhnga Mitrovica, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje, Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1, lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, të akuzuarit A.Xh edhe për shkak të veprës penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke vendosur në lidhje me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, A.XH, av. Gani Rexha, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr. 77/2024, të datës 25.09.2024, në seancën e kolegjit me datë 11.12.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit A.XH, av. Gani Rexha, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr. 77/2024, i datës 25.09.2024, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin, PKR.nr.77/2024, të datës 25.09.2024, të akuzuarit A.Xh dhe Fitim Xhema, i ka shpallur fajtor

për veprën penale në bashkëkryerje, Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të akuzuarin A.Xh edhe për veprën penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, dhe janë gjykuar si në vijim: i akuzuari A.Xh për veprën penale si në pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar më dënim me burgim në kohëzgjatje prej njëqind e pesëdhjetë (150) ditë, ndërsa për veprën penale si në pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar më dënim me burgim në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë (90) ditë. Në bazë të nenit 76, par.1 dhe par.2, nënpar.2.2 të KPRK-së, i është shqiptuar dënim unik më burgim në kohëzgjatje prej njëqind e tetëdhjetë (180) ditë, i cili dënim, në bazë të nenit 44 të KPRK-së, dhe me pëlqimin e tij, i është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej dymijë e pesëqind (2,500.00) Euro, të cilin dënim i akuzuari është obliguar që ta paguajë në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditëve, pasi ky aktgjykim të merrë formën e prerë. Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mundet të paguajë dënimin e zëvendësuar me gjobë në shumë prej dymijë e pesëqind (2,500.00) Euro, në afatin e përcaktuar nga gjykata, atëherë ai do të vuajë dënimin me burgim në kohëzgjatje prej njëqind e tetëdhjetë (180) ditë. Të akuzuari F.Xhpër veprën penale si në pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar i është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej tetëdhjetë e shtatë (87) ditë, i cili dënim do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, duke i llogaritur në dënimin me burgim, edhe kohën e kaluar nën masën e paraburgimit nga data 16.07.2024 deri më datë 13.09.2024.

Gjykata duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 366 par.3 të KPRK-së, lidhur me nenin 276 par.1 të KPPK-së, ka urdhëruar konfiskimin e përhershëm të armës revolver me numër serik A..., me mbishkrim M... in B... dhe tre fishekë të kalibrit ende të panjohur, e cila armë duhet të shkatërrohet nga Policia e Kosovës, pasi ky aktgjykim të merrë formën e prerë, nëse vërtetohet së e njëjta nuk është përdorur në ndonjë rast tjetër të hapur.

Të akuzuarit janë obliguar që t'i paguajnë në emër të shpenzimeve të procedurës penale shumën prej 20.00 € (njëzetë euro), secili veç e veç, në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20.00 € (njëzetë euro), secili veç e veç, si dhe në emër të taksës së kompensimit të viktimave të krimit shumën prej pesëdhjetë (50.00) Euro, secili veç e veç, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merrë formën e prerë.

Pala e dëmtuar Shpend (Enver) Xhemajli, me vendbanim në Mitrovicë Rr."Hasan Prishtina", Kati -I- rë, Nr.8, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, është udhëzuar në kontest të rregulltë civil.

Kundër këtij aktgjykimi ka parashtruar ankesë mbrojtësi i të akuzuarit A.XH, av. Gani Rexha, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata Apelit e Kosovës, aktgjykimin e ankimuar t'a ndryshoj ashtu që të akuzuarit t'ia zbus dënimin e shqiptuar duke i shqiptuar një dënim me të butë me gjobë me të cilin do të arrihej mjaftueshëm qëllimi i dënimit.

Prokurori i Apelit me parashtrësën më shkrim, PPA/I.nr.606/2024, të datës 13.11.2024, ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtësi të akuzuarit A.XH, av. Gani Rexha, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.77/2024, i datës 25.09.2024, të vërtetohet.

Konform nenit 390 par.1 të KPPK-së, më datë 11.12.2024, u caktua seanca e kolegjit në të cilën nuk prezantuan palët edhe pse të gjithë ishin të njoftuar në mënyrë të rregullt gjyqësore për kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës.

Gjykata e Apelit pasi që ka studiuar aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit A.XH, propozimin e Prokurorisë së Apelit, dhe duke analizuar shkresat e lëndës në këtë çështje penale në vështrim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale, gjeti se:

*Ankesa nuk është e bazuar.*

*Pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit A.XH, av. Gani Rexha*

Mbrojtësi në ankesë ka theksuar se vendimi mbi sanksionin penal i shqiptuar ndaj të mbrojturit të tij është tepër i rëndë si pasojë e vlerësimit të gabuar të rrethanave lehtësuese, se gjykata me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit nuk ka marrë parasysh fare faktin se i akuzuari është i gjendjes së varfer ekonomike dhe i pa punë. Sikur gjykata ta vlerësonte këtë rrethanë lehtësuese me siguri se vendimi mbi sanksionin penal do të ishte shumë më i butë se sa që është shqiptuar nga gjykata. Përveq kësaj gjykata nuk ka marrë si rrethanë lehtësuese edhe faktin se kontribut të madh në kryerjen e veprave penale ka dhënë edhe pala e dëmtuar e cila në vend që ti kaloj pushimet vjetore së bashku me familjen e tij të ngushtë, i njëjti gjenë rrugën e sulmimit të të akuzuarit F.Xh(vëllai i të akuzuarit Arian) për një problem para tri viteve, duke e sulmuar ditën kritike fizikisht të akuzuarin Fitim dhe duke i shkaktuar lëndime trupore. Ky provokim i të dëmtuarit ndaj të akuzuarve Arian dhe F.Xhsikur të vlerësohej mirë nga gjykata shkallës së parë me siguri se vendimi mbi sanksionin penal do të ishte më i favorshëm për të akuzuarin. Nga këto arsye ka propozuar që Gjykata Apelit ankesën ta aprovoj të bazuar,

aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj ashtu që të mbrojturit të tij ti shqiptoj një dënim me gjobë me të butë.

### Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë edhe pse me ankesë nuk kundërshtohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi në këtë aspekt – konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së, dhe konstatoi se nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat kishin më kushtëzuar anulimin e tij, dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarve.

Po ashtu, me ankesë nuk kontestohet as gjendja faktike të cilën e ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë, prandaj as në këtë aspekt çështja nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj Gjykate (në fakt as që ka mund të kontestohet aktgjykimi përkitazi me këtë bazë ankimore ngase i akuzuari ka pranuar fajësinë), kurse aktgjykimi u vlerësua vetëm në frymë të pretendimeve ankimore sa i përket vendimit për dënim.

Duke shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënim, Gjykata Apelit, gjen se pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit A.XH, për zbutje të dënimit, nuk janë të bazuara.

Gjykata e shkallës së parë më rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, për të akuzuarit ka vlerësuar rrethanat për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 73 të KPRK-ës, ashtu që për të akuzuarin A.Xh si rrethana rënduese ka vlerësuar, dashjen direkte të akuzuarit të këto vepra penale, shkallën e përgjegjësisë penale, përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e plotë, kontributin esenciale të tij në kryerjen e veprave penale, faktin se kjo natyrë e veprave penale janë më të shpeshtuara në Kosovë dhe rrezikshmërinë që paraqesin këto vepra penale. Përveç rrethanave të sipërtheksuara, si rrethanë tjetër rënduese gjykata ka vlerësuar edhe dënimet e mëparshme penale ndaj këtij të akuzuarit ngase i njëjti edhe më parë ka qenë i dënuar për vepra të tilla penale të kësaj natyre dhe atë sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.222/2021, të datës 04.02.2022, i plotëfuqishëm me datë 10.03.2022, për veprën penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, dhe veprën penale, Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 të KPRK-së, aktgjykim i cili gjendet i ngarkuar dhe në Programin SMIL, si dhe kopja e të cilit gjendet në shkresat e lëndës. Ndërsa si rrethanë lehtësuese ndaj të akuzuarit A.XH, gjykata ka vlerësuar se i njëjti, ka shprehur publikisht keqardhje dhe pendim për rastin, dhe si rrethanë posaçërisht lehtësuese është vlerësuar pranimiti i fajësisë në tërësi për veprat penale që akuzohet që nga momenti i parë, duke

bashkëpunuar kështu në mënyrë të plotë me organet e rendit, duke ndihmuar në zbardhjen e plotë dhe të tërësishme të veprave penale. Gjykata për të akuzuarin F.Xh si rrethana rënduese ka vlerësuar po ashtu dashjen direkte, kontributin e tij të vepra penale, mënyrën e kryerjes e veprës penale, ndërsa, si rrethanë lehtësuese ndaj këtij të akuzuari gjykata ka vlerësuar se i njëjti, gjithashtu ka shprehur publikisht keqardhje dhe pendim për rastin, dhe si rrethanë posaçërisht lehtësuese edhe për këtë të akuzuar ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale që akuzohet që nga momenti i parë, duke bashkëpunuar kështu në mënyrë të plotë me organet e rendit, duke ndihmuar në zbardhjen e plotë dhe të tërësishme të veprës penale.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi me burgim i zëvendësuar me gjobë ndaj të akuzuarit F.Xh duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprave penale dhe shkallën e përgjegjësisë së tij. Sa i përket dënimit me gjobë të zëvendësuar për këtë të akuzuar në këtë rast gjykata përveç rrethanave të cekura, ka vlerësuar dhe ka marrë parasysh edhe kushtet dhe mundësitë materiale për pagimin e gjobës, duke vlerësuar se dënimi me gjobë i shqiptuar për këtë të akuzuar është i përballeshëm për kushtet ekonomike, për çka i ka lënë afatin e pagesës në kohëzgjatje prej gjashtëdhjetë (60) ditëve. Gjithashtu, sipas bindjes së gjykatës, dënimi me burgim ndaj të pandehurit F.Xh duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së tij. Andaj, Gjykata duke u bazuar në rrethanat e cekura si më lartë të akuzuarve u ka shqiptuar dënime si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Një vlerësim të tillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo Gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa rrethanat e pretenduara në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit A.XH, av. Gani Rexha, se i akuzuari është i gjendjes së varfër ekonomike, se gjykata nuk ka marrë si rrethanë lehtësuese edhe faktin se kontribut të madh në kryerjen e veprave penale ka dhënë edhe pala e dëmtuar, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate nuk janë të asaj natyre dhe nuk kanë ndikim që të akuzuarit ti shqiptohen dënim tjetër nga ai që i ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, për me tepër mbrojtësi pretendimit se i

mbrojturi i tij nuk ka gjendjen e mirë ekonomike nuk i ka bashkangjitur asnje provë që do ta vërtetonte këtë fakt, ndërsa siç rezulton nga shkresat e lëndë i akuzuari gjatë deklarimit lidhur me të dhenat e tij ka deklaruar se ka gjendje të mesme ekonomike, andaj, këto rrethana sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj Gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Prandaj, kjo Gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarve nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve si ekzekutor, dhe me intensitetin e rrezikimit apo pasojave të shkaktuara dhe se me të do të mund të parandalohen të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmën, si dhe do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Nga arsyet e sipërcekura, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për Krime të Rënda  
PAKR.nr.667/2024, datë 11.12.2024

Bashkëpunëtorja Profesionale

Kryetari i kolegjit

---

Fitore Batatina

---

Mentor Bajraktari

Anëtarët e kolegjit:

---

Afërdita Bytyçi

---

Valbona Musliu Selimaj